



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVSTVA-MINISTRY OF HEALTH	
Njesia Org. Org. Jedinica Org Unit	01
Nr. Prot. Broj Prot. Prot.No	05-2655
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	-06-
Data: Datum:	21.04.2021
Prishtinë / a	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**  
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health  
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

Nr. 223/IV/2021

Datë:20.04.2021

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (GZ Nr. 7, 01 mars 2019), nenin 8 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, bazuar në nenin 5 paragrafi 2 nënparagrafi 2.5 të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në Territorin e Republikës së Kosovës (GZ Nr. 3/2020, 25 gusht 2020), nenin 9 paragrafi 1.3 dhe nenin 89 të Ligjit nr.04/L-125 për Shëndetësi (GZ Nr. 13/2013, 07 maj 2020), në zbatim të Vendimit Nr. 01/11 të datës 15.03.2020 për Shpalljen e Emergjencës së Shëndetit Publik dhe të pikës 42 dhe 42 të Vendimit Nr.01/07 të datës 18.04.2021 për Masat e Përgjithshme dhe të Veçanta për Kontrollin, Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19, nxjerr:

**V E N D I M**

**Për aprovimin e Udhëzuesit të përkohshëm - Aplikimi i masave të përgjithshme dhe të veçanta për parandalimin dhe luftimin e COVID-19 në institucionet korrektuese, qendrat e azilit dhe të mbajtjes për të huaj**

1. Aprovohet Udhëzuesi i përkohshëm - Aplikimi i masave të përgjithshme dhe të veçanta për parandalimin dhe luftimin e COVID-19 në institucionet korrektuese, qendrat e azilit dhe të mbajtjes për të huaj (verzioni 1.0)
2. Udhëzuesi është i obligueshëm për të gjithë personat dhe sektorët ndaj të cilëve zbatohet.
3. Shtojca e bashkangjitur këtij vendimi, është pjesë përbërëse e tij.
4. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm që përmes Qarkores Informative të informoj të gjitha institucionet dhe palët e interesit për aprovimin e këtij udhëzuesi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

Vendim i dërgohet:

- Zyrës së Kryeministrit;
- Të gjitha ministrive
- Sekretarit të Përgjithshëm të MSh;
- Departamentit ligjor të Msh;
- Divizionit për komunikim me publikun të Msh;
- Arkivit të MS

**Dr. Arben Vitia**  
Ministër i Shëndetësisë



**Shtojca 1** : Udhëzues i përkohshëm - Aplikimi i masave të përgjithshme dhe të veçanta për parandalimin dhe luftimin e COVID-19 në institucionet korrektuese, qendrat e azilit dhe të mbajtjes për të huaj (verzioni 1.0)



*Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health*

**UDHËZUES I PËRKOHSHËM  
APLIKIMI I MASAVE TË PËRGJITHSHME DHE TË  
VEÇANTA PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E COVID-  
19 NË INSTITUCIONE KORREKTUESE, QENDRA TË AZILIT  
DHE TË MBAJTJËS PËR TË HUAJ**

**Prishtinë, Prill 2021**

**Verzioni 1.0**

## **Udhëzime specifike të parandalimit të përhapjes së COVID-19 në institucionet korrektuese, qendrat e azilit dhe të mbajtjes për të huaj**

### **1. Promovoni dhe respektoni distancën fizike**

Zbatimi i masave të distancës fizike në institucionet korrektuese, qendrat e azilit dhe të mbajtjes për të huaj mund të jetë mjaft sfidues duke qenë se mund të jenë të mbipopulluara dhe pa kushte adekuate për të i zbatuar këto masa. Mirëpo, duhet bërë të gjitha përpjekjet në mënyrë që të aplikohen standardet e njëjta të distancës fizike sikurse ato që aplikohen në komunitetin e gjerë.

Masat që duhen të zbatohen për t'u respektuar distanca fizike për këto grupe përfshijnë:

- Pjesëtarët e këtyre qendrave mund të ndahen në grupe të ndryshme, në mënyrë që të shmangët kontakti me njëri-tjetrin.
- Koha e ushqimit duhet të organizohet në ndërrime për të zvogëluar grumbullimin.
- Qasja në objektet e higjienës të bëhet në vende të ndryshme.
- Qasja në institucione shëndetësore të bëhet në vende të ndryshme apo kohë të ndryshme
- Kufizimi i vizitorëve në qendrat e pritjes dhe paraburgimit dhe zvogëlimi, kur është e mundur.
- Duhet reduktuar numri i stafit dhe të mundësohet që vetëm stafi mjekësor të jetë prezent
- Shenjzimi i dyshemesë në zonat e përbashkëta mund të ndihmojë në inkurajimin e njerëzve që të mbajnë distancën fizike prej 2 metra.
- Izolimi i rasteve me COVID-19 dhe personave me simptoma të COVID-19.
- Personat mbi 60 vjeç, dhe me sëmundje shoqëruese si tension të lartë, diabet, imunitet të dobësuar dhe obezitet duhet ndarë në zona të veçanta në mënyrë që të zvogëlohet rreziku nga infeksioni.
- Identifikimi i mjediseve alternative të akomodimit, për të ulur numrin e pjesëtarëve në qendra dhe për të siguruar strehim për azilkërkuesit, refugjatët dhe migrantët e sapoardhur në rast se një objekt aktual vendoset nën karantinë.
- Distanca fizike ndër-personale nuk mund të mirëmbahet gjithmonë në disa mjedise (p.sh. gjatë transferimeve të të burgosurve) ose kur kontakti fizik është i nevojshëm (si p.sh. gjatë ofrimit të kujdesit shëndetësor). Në këto situata, zbatimi i masave të tjera parandaluese të rrepta (p.sh. përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale -PPM) është thelbësor për zvogëlimin e rrezikut të transmetimit.

### **2. Mbani dhe inkurajoni higjienën e duarve**

- Qendrat duhet siguruar sapun dhe ujë dhe qasje të lehtë për të gjithë banorët (azil-kërkuesit, refugjatët, të burgosurit), stafin dhe vizitorët.
- Nëse sapuni dhe uji nuk janë në dispozicion duhet siguruar dezinfektues duarsh me bazë alkooli 60-70%, megjithëse këto të fundit mund të paraqesin rreziqe të sigurisë për shkak të potencialit për abuzim.
- Duhet inkurajuar higjiena rigoroze e duarve, sidomos pas kontaktit me sipërfaqet e prekura shpesh, para dhe pas përgatitjes së ushqimit, para ngrënies, pirjes së duhanit, pasi keni qenë jashtë për ushtrime dhe pas përdorimit të tualetit ose hudhjen e mbeturinave.

### **3. Mbani dhe inkurajoni mbajtjen e maskës/mbulesës së fytyrës për stafin dhe klientët**

- Përdorimi i maskave të fytyrës duhet të konsiderohet vetëm si një masë plotësuese, dhe jo si një masë zëvendësuese për masa thelbësore parandaluese si larja e duarve, vendosja e faculetave gjatë kollitjes apo teshtitjes dhe distancës fizike.
- Çdo person duke përfshirë stafin dhe banorët e këtyre qendrave si dhe vizitorët, duhet të vendosin maskë ose të mbulojnë fytyrën në një mënyrë që mbulon hundën dhe gojën.
- Informacioni në lidhje me përdorimin e duhur të maskave të fytyrës duhet të jetë në dispozicion.

### **4. Përdorni pajisjet personale mbrojtëse (PPM)**

- Përdorimi i maskave filtruese (FFP) nuk rekomandohet për të burgosurit.
- Punonjësit shëndetësorë që ofrojnë kujdes shëndetësor për pacientët që tregojnë simptoma të përputhshme me COVID-19 në qendra korrektuese, të mbajtjes dhe ato të azilit duhet të përdorin maskat FFP.
- Përdorimi i maskave filtruese (FFP) duhet të përdoret edhe gjatë realizimit të procedurave me rrezik të lartë (p.sh. ekzaminimi fizik i orofaringut ose shtupës nazofaringeale) dhe ekzaminimit edhe të pacientëve pa simptoma të përputhshme me COVID-19.
- Syzet ose mburoja e fytyrës dhe dorëzat duhet të përdoren me maska filtruese kur ofrojnë kujdes shëndetësor për pacientët me simptoma të përputhshme me COVID-19 ose gjatë realizimit të procedurave me rrezik të lartë.
- Konsideroni përdorimin e një rrobave mbrojtëse të gjata, veçanërisht nëse ekziston rreziku i ekspozimit ndaj lëngjeve të trupit.
- Të gjithë punonjësit e kujdesit shëndetësor në qendra korrektuese dhe mbajtëse duhet të mbajnë vazhdimisht një maskë mjekësore gjatë aktiviteteve të tyre rutinore.
- Personeli i përfshirë në transferimin e rasteve të dyshimta ose të konfirmuara të COVID-19 në qendra korrektuese duhet të përdorin maska mjekësore për fytyrën ose filtruese (FFP2), bazuar në vlerësimin e kontaktit të mundshëm me rastin. Gjatë transportit, i burgosuri i dyshuar ose i konfirmuar me COVID-19 duhet të mbajë një maskë mjekësore në fytyrë.

### **5. Zbatoni masat e pastrimit dhe dezinfektimit**

- Sipërfaqet e prekura shpesh duhet të pastrohen sa më shpesh që të jetë e mundur (të paktën çdo ditë dhe nëse është e mundur më shpesh), veçanërisht në hapësirat publike. Shembuj të këtyre sipërfaqeve janë dorezat e derës dhe shufrat e dyerve, karriget dhe mbështetëse krahësh, maja tavoline, çelësa dritash, etj.
- Përdorimi i një detergjenti neutral për pastrimin e sipërfaqeve në ambientet e përgjithshme (d.m.th. jo për ambientet ku një rast i dyshuar ose i konfirmuar i COVID-19 ka qenë) duhet të jetë i mjaftueshëm.
- Pastrimi i tualeteve të përbashkëta, lavamanëve të banjës dhe pajisjeve sanitare duhet të kryhet me kujdes.

- Personeli i pastrimit duhet të veshë pajisje mbrojtëse personale (PPE) (p.sh. uniformë e cila hiqet dhe lahet shpesh në ujë të ngrohtë dhe detergjent dhe dorëza) kur pastrojnë.
- Udhëzime të ngjashme duhet t'u jepen banorëve të qendrave për pastrimin e dhomave të tyre.

#### **6. Mirëmbani sistemet e ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të ajrit**

- Qendrat korrektuese, të azilit dhe ato të mbajtjes duhet të kryejë një rishikim të rregullt të sistemeve të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të ajrit për t'u siguruar që ato funksionojnë si duhet.
- Rritni qarkullimin e ajrit të jashtëm duke maksimizuar raportin e ajrit të jashtëm ose duke hapur dritare dhe dyer, kur është e mundur.
- Shmangni riciklimin e ajrit

### **Modeli i funksionimit në kontekstin e COVID-19**

#### **7. Testimi për COVID-19**

- Të gjithë personat në qendra korrektuese, qendra të azilit dhe ato të mbajtjes me simptoma të COVID-19, duhet të testohen.
- Të burgosurit, migrantët, azil-kërkuesit që vijnë (të rinjë, të transferuar nga institucione të tjera ose që hyjnë e dalin nga ambientet), për të zvogëluar rrezikun e përhapjes së COVID-19, kurdo që është e mundur.

#### **8. Menaxhimi i rasteve të dyshimta, të mundshme ose të konfirmuara të COVID-19**

- Procedurat duhet të planifikohen dhe të bien dakord në bashkëpunim midis Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) për të menaxhuar rastet në këto qendra.
- Personeli klinik duhet të vlerësojë individët me simptoma të COVID-19 në një vend të caktuar mjekësor dhe të përcaktojnë nëse ata duhet të testohen ose të ndërmerren veprime të mëtejshme.

#### **9. Konsiderata ndaj stafit, të burgosurve, azilkërkuesve dhe të huajve**

- Nëse stafi, të burgosurit dhe azilkërkuesit dyshohet të kenë COVID-19, ata duhet të izoloohen pavarësisht nëse kanë simptoma apo jo.
- Nëse stafi, të burgosurit dhe azilkërkuesit kanë qenë të ekspozuar ndaj COVID-19, duhet të paraqiten te mbikëqyrësi ose mjeku i institucionit dhe t'i respektojnë rekomandimet nga IKShPK.

## 10. Plani i sigurisë

- Të përshkruhen masat/procedurat që duhet zbatuar në institucion për të zvogëluar përhapjen e COVID-19.
- Të sigurohet zbatimi i masave për ekzaminim, distancë fizike, maska, pastrimi dhe dezinfektimi të sipërfaqeve dhe objekteve dhe mbajtjen e pajisjeve personale mbrojtëse (PPM).
- Të shkruhen me shkrim dhe vihen në dispozicion për të burgosurit, azilkërkuesit dhe migrantët, stafin dhe vizitorët.
- Të caktohet një person kryesor që do të jetë përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e planit të sigurisë.